

VENDIM
Nr. 27, datë 29.1.2021

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “AGETA” SHPK NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “BORIE – LURË 1” ME
KAPACITET TË INSTALUAR 1800 kw**

(ndryshuar me vendimet nr. 104, datë 22.4.2021; nr. 310, datë 30.11.2022; nr. 226, datë 30.9.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, të nenit 5, pika 1, germa “a”, dhe të nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.1.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 15/3 prot., datë 26.1.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “Ageta” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 259, datë 28.12.2020, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Ageta” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendndodhje në ujërat e përrenjve të kurorës së Lurës, degë e Lumit Drin i Zi, Bashkia Dibër.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje me “Njoftimin për licencim” nr. 62/47 prot., datë 29.12.2020, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Ageta” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 32 prot., datë 11.1.2021, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “Ageta” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 32/1 prot., datë 18.1.2021 dhe nr. 32/2 prot., datë 25.1.2021, ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë prodhimi të energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Dokumentacioni i këtij aplikimi është tërësisht i plotësuar si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, gerrat: “a”, “b”, “c”. Plotësuar;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, gerrat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”. Plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gerrat: “a”, “b”, “c”, “d”. Plotësuar;

- dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pika 4.1.1 (të dhëna teknike për HEC); 4.1.2 (të dhëna teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin); 4.1.3 (dokumentacioni tekniko-ekonomik), gerrat: “a”, “b”, “c”, “d”; 4.1.4 (dokumentacioni tekniko-ekonomik), gerrat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe pika 4.1.5 (lejet nga institucionet e tjera), gerrat: “a”, “b”, “c”. Plotësuar.

- Shoqëria duhet të dokumentojë në ERE, brenda 3 muajve, miratimin nga MIE të shoqërisë “Ageta” sh.p.k. si përfaqësuese dhe zbatuese, në vijim të kontratës nr. 65 rep., nr. 38/1 kol., datë 16.1.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Borie – Lurë 1’, me

kapacitet prodhues 1800 kw, në rrjedhën e përrrenjve të kursorës së Lurës, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Dibër, qarku Dibër, pas tërheqjes/largimit të shoqërisë “Bajrami N” .

- Në përfundim të afatit të kontratës së qirasë me Bashkinë Dibër (data e përfundimit 16.11.2027), shoqëria duhet ta depozitojë atë me afate të rinovuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit.

- Në përfundim të afatit të lejes së përdorimit të burimit ujor (data e përfundimit 9.4.2022), do t'i kërkohet shoqërisë ta depozitojë atë me afate të rinovuara, një muaj pas rinovimit të saj.

- Kontrata nr. 65 rep., nr. 38/1 kol., date 16.1.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Borie – Lurë 1’, me kapacitet prodhues 1800 kw, në rrjedhën e përrrenjve të kursorës së Lurës, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Dibër, qarku Dibër”, e lidhur midis MIE-s dhe mbajtësit të miratimit, bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Ageta” sh.p.k., dhe “Bajrami N” sh.p.k., ka një afat 49-vjeçar, por nga ana tjetër shpjegojmë se ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe të nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Ageta” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Borie – Lurë 1”, me kapacitet të instaluar 1800 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. *Shfuqizuar.*

3. *Shfuqizuar.*

4. *Shoqëria do të depozitojë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujor të rinovuar jo më vonë se data 25.10.2027.*

5. *Shfuqizuar.*

6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe MIE-n për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti